Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 54-të, të mbajtur më 02.11.2021, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 09-639/1 e datës 09.02.2021, e cila shpreh pakënaqësi me punën e disa gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, REFUZOHET

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 09.02.2021 të datës 09.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga ana e parashtruesit të njohur me datë 09.02.2021, është dorëzuar denoncim në të cilën shprehët pakënaqësi me punën e disa gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në disa gjykata, pas së cilës është formuar lënda me numër 09-639/1 nga data 09.02.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se gjyqtarët, avokatët, prokurorët publikë përmes konfliktit të interesit fajësojnë qytetarët. Kërkon përshpejtimin e rastit, për të cilin në Gjykatën ///është ngritur kallëzim penal kundër prokurorit publik ///.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK konstaton se në lëndën nuk ka elemente për veprim kompetent në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave për shkak se për momentin është në procedurë gjyqësore para gjykatës kompetente.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: SM
Miratoi: KN, anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORË PËR
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska